



PDK-ja DHE AAK-ja: KËRKESA E OSMANIT PËR KUSHTETUESEN I JEP KOHË VETËVENDOSJES

FAQE 4-5



Deputetë të partive opozitare në legjislaturën e kaluar të Kosovës e kanë konsideruar të vonuar kërkesën e presidentes Vjosa Osmani drejtuar Gjykatës Kushtetuese për sqarim lidhur me atë se çfarë do të ndodhë pas

datës 26 korrik, në rast se deri atëherë nuk konstituohet Kuvendi i Kosovës. Deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, ka thënë se kërkesa e presidentes për masë të përkohshme është e gabuar, pasi i jep më shumë kohë

Lëvizjes Vetëvendosje. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, theksoi se vendimi i Osmanit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese i jep Vetëvendosjes edhe disa ditë kohë për bllokadën

**PËRPLASEN
MUSLIU - DEHARI,
NDËRPRITET
SEANCA PËR
KONSTITUIMIN
E KUVENDIT** F. 3



**BIE NUMRI I PËRFITUESVE
NGA NDIHMA SOCIALE** F. 8



**BRITANIA SANKSIONON DHJETËRA
PERSONA, PËRFSHIRË NJË SHOQIPTAR** F. 2

**GJERMANIA DO GARANCI NGA
SHBA-ja PËRPARA SE T'I DËRGOJË
RAKETAT PATRIOT NË UKRAINË** F. 2

**MAQEDONCI TAKOHET ME
HOMOLOGUN TURK, DISKUTOJNË
PËR SIGURINË DHE FABRIKËN
E MUNICIONIT** F. 3

**TALAT XHAVERI VIZITON AKB-në,
VLERËSON ROLIN E SAJ SI URË
LIDHËSE MES KOMUNITETEVE TË
BIZNESIT** F. 8

**KUSHTET MË TË KËQIJA
PËR PUNË NË EVROPË,
KU POZICIONOHET KOSOVA?** F. 8

SPORT



**KB BASHKIMI DHE KBF PEJA MËSOJNË
KUNDËRSHTARËT NË GARAT EVROPIANE** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania sanksionon dhjetëra persona, përfshirë një shqiptar

LONDËR, 23 KORRIK - Mbretëria e Bashkuar ka vendosur sanksione ndaj dhjetëra personave, grupeve dhe furnizuesve nga Ballkani, Lindja e Mesme dhe Kina, të cilët akuzohet se kanë ndihmuar migrantët që ta kalojnë Kanalin e La Manshit. Në mesin e të sanksionuarve është edhe një shqiptar. Njoftimi për vendosjen e sanksioneve vjen në një kohë kur qeveria britanike po përballet me presion politik për ta ndaluar valën e arritjeve në shifra rekorde të migrantëve të cilët po shkojnë në Mbretërinë e Bashkuar me varka të vogla nga veriu i Francës. Kjo është hera e parë që Mbretëria e Bashkuar përdor regjimin e ri të sanksioneve për migrimin e paligjshëm global. Në total, 20 individë dhe katër banda u sanksionuan - dy grupe nga Ballkani dhe dy me origjinë nga Afrika e Veriut që operonin në Ballkan, si dhe kompania kineze Weihai Yamar Outdoor Product Co.

Në mesin e të sanksionuarve është shqiptari Bledar Lala. Sipas Mbretërisë së Bashkuar, ai kontrollon "operacionet belge" të një grupi të organizuar kriminal që është i përfshirë në kalimet e paligjshme. Është sanksionuar edhe banda Kavaç, një grup i krimit të organizuar nga Ballkani, që njihet për përdorimin e pasaportave false për t'i kontrabnuar anëtarët e vet nga Ballkani në Turqi. Po ashtu, banda Shkalari, një grup i krimit të organizuar në Mal të Zi që kontrabandën kriminelë mes Ballkanit dhe Turqisë, është në listën e sanksioneve. Mbretëria e Bashkuar, po ashtu, ka shënjestruar Alen Basil, ish-përkthyes policor, i cili akuzohet se aktualisht drejton një rrjet të madh të trafikimit të migrantëve në Serbi, duke "terrorizuar refugjatët me ndihmën e policëve të korruptuar". Po ashtu, sanksione janë vendosur ndaj Mohammed Tetwani, të cilin autoritetet



britanike e përshkruajnë si "mbret të Horgoshit" për shkak të mënyrës brutale me të cilën, sipas Londrës, menaxhon një kamp migrantësh në qytetin serb Horgosh. Personat e sanksionuar dhe entitetet përballen me ngrirje të

aseteve dhe ndalesë të udhëtimeve, tha Zyra për Punë të Jashtme e Britanisë. Sekretari i Jashtëm britanik, David Lammy, e quajti këtë "një moment historik të punës së qeverisë për ta luftuar krimin e organizuar sa i përket migrimit",

që tha se po prek Mbretërinë e Bashkuar. Pothuajse 24 000 migrantë kanë kaluar Kanalin e La Manshit deri më tani më 2025 - që është shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë për këtë periudhë të vitit.

Gjermania do garanci nga ShBA-ja përpara se t'i dërgojë raketat Patriot në Ukrainë

BERLIN, 23 KORRIK - Gjermania ka nevojë për garanci të forta nga ShBA-ja se do të marrë shpejt sisteme të tjera raketore Patriot si zëvendësim nëse ajo dërgon dy nga njësitë e saj në Ukrainë, tha ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius. Duke folur për revistën gjermane "Der Spiegel", ai tha se vendet evropiane anëtare të NATO-s kanë nevojë për garanci "të hekurt" që çdo sistem amerikan i mbrojtjes ajrore Patriot, i dërguar në Ukrainë, do të zëvendësohet brenda një periudhe prej gjashhtë deri në tetë muajsh. Javën e kaluar presidenti i ShBA-së, Donald Trump, bëri me dije se ka arritur një marrëveshje me shefin e NATO-s, Mark Rutte, që vendet



evropiane të aleancës të furnizohen me armë amerikane - sidomos me sistemet raketore Patriot - për ta ndihmuar Ukrainën në luftën kundër Rusisë.

Ky veprim shënoi një kthesë në qëndrimin e Trumpit, i cili tha se është gjithnjë e më i pakënaqur me presidentin rus Vladimir Putin, që po pengon përpjekjet për t'i dhënë fund

luftës në Ukrainë. Gjermania ka ofruar financimin e dy sistemeve Patriot, ndërsa disa aleatë të tjerë të NATO-s janë shprehur të gatshëm të paguajnë për tri të tjera. Por, shqetësimet janë rritur, pasi Uashingtoni do që aleatët evropianë fillimisht t'i dërgojnë sistemet Patriot nga rezervat e tyre në Ukrainë dhe më pas të presin që ato të zëvendësohen nga Shtetet e Bashkuara. Pistorius i tha revistës "Der Spiegel" se është e rëndësishme që "vendet që po i transferojnë sistemet, të mund t'i përmbushin detyrimet e tyre ndaj NATO-s dhe të mos krijohen boshllëqe sigurie për aleancën". Disa vende, si Norvegjia, Suedia dhe Holanda, kanë shprehur

gatishmëri të paguajnë për sistemet Patriot, por Pistorius tha se ende nuk është vendosur se cili vend do t'ia japë këto sisteme Ukrainës. Duke folur më vonë në një konferencë për medie në Berlin, ai tha se po vazhdojnë bisedimet për çështjen se "cilat vende në Evropë dhe më gjerë kanë aktualisht sisteme Patriot dhe sa prej tyre janë të gatshme t'i dorëzojnë". "Ka para për këto sisteme Patriot. Tani vetëm na duhen ato", tha Pistorius. Gjermania ka pasur 12 sisteme Patriot, por tashmë ka dërguar 3 prej tyre në Ukrainë dhe 2 në Poloni. Një sistem tjetër përdoret vetëm për trajnime, kështu që tani i ka vetëm 6 sisteme aktive në dispozicion.

Mbi 100 organizata kërkojnë masa urgjente për ta ndaluar urinë në Gazë

GAZA, 23 KORRIK - Mbi 100 organizata humanitare dhe të drejtave të njeriut u bënë thirrje qeverive të ndërmarrin veprime urgjente për ta ndaluar përhapjen e urisë në Gazë. Ato, gjithashtu, kërkuar armëpushim të menjëhershëm dhe të përhershëm, si dhe heqjen e të gjitha pengesave për shpërndarjen e ndihmave humanitare.

Në deklaratën e nënshkruar nga 111 organizata, përfshirë Mercy Corps, Këshillin Norvegjez për Refugjatët dhe Refugees International, paralajmërohet se uria në Gazë po përhapet me shpejtësi të madhe, ndërkohë që ndihmat jetike, si ushqimi, uji dhe barnat, qëndrojnë të pashpërndara pranë kufirit, pasi organizatatave humanitare u

ndalohet të veprojnë. "Derisa rrethimi i Qeverisë izraelite po i lë të uritur banorët e Gazës, punonjësit e ndihmave po bashkohen me ta në radhët për ushqim, duke rrezikuar të qëllohen. Furnizimet kanë mbaruar plotësisht dhe organizatat humanitare po shohin kolegët dhe partnerët e tyre teksa rraskapiten para syve të tyre", thuhet në reagim.



PDK-JA DHE AAK-JA: KËRKESA E OSMANIT PËR KUSHTETUESEN I JEP KOHË VETËVENDOSJES

Deputetë të partive opozitare në legjislaturën e kaluar të Kosovës e kanë konsideruar të vonuar kërkesën e presidentes Vjosa Osmani drejtuar Gjykatës Kushtetuese për sqarim lidhur me atë se çfarë do të ndodhë pas datës 26 korrik, në rast se deri atëherë nuk konstituohet Kuvendi i Kosovës. Deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, ka thënë se kërkesa e presidentes për masë të përkohshme është e gabuar, pasi i jep më shumë kohë Lëvizjes Vetëvendosje. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, theksoi se vendimi i Osmanit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese i jep Vetëvendosjes edhe disa ditë kohë për bllokadën

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 KORRIK - Disa deputetë të partive opozitare në legjislaturën e kaluar të Kosovës e kanë konsideruar të vonuar kërkesën e presidentes Vjosa Osmani drejtuar Gjykatës Kushtetuese për sqarim lidhur me atë se çfarë do të ndodhë pas datës 26 korrik në rast se deri atëherë nuk konstituohet Kuvendi i Kosovës. Osmani ka kërkuar një masë të përkohshme për pezullimin e afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit, afat ky që ka filluar të llogaritet nga 26 qershori, datë kur Gjykata Kushtetuese ka marrë vendimin. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rashit Qalaj, tha se kërkesa e presidentes për masë të përkohshme është e gabuar, pasi i jep më shumë kohë Lëvizjes Vetëvendosje - partisë më të madhe në Kuvend - për ta vazhduar bllokimin e institucioneve të Kosovës. “Presidentja është dashur shumë më herët t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, pasi që kemi kaluar një kohë shumë të gjatë. Kemi humbur muaj të tërë dhe ende nuk po arrijmë të gjejmë një zgjidhje”, tha Qalaj.

Edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, theksoi se situata nuk është e mirë. Ai shtoi se vendimi i Osmanit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese i jep Vetëvendosjes edhe disa ditë kohë për bllokadën. Haradinaj shfaqti shpresën që Kushtetuesja të mos vonojë më vendimet. Fatmir Limaj nga Nisma Socialdemokrate, megjithatë, tha pas seancës se kërkesa e presidentes drejtuar Gjykatës Kushtetuese e ndihmon procesin jo vetëm për konstituimin e Kuvendit, por edhe për të ardhmen. Pavarësisht prej dhjetëra përpjekjeve, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të konstituohet për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Fituesja e zgjedhjeve të 9 shkurtit, Vetëvendosje, ka propozuar Albulena Haxhiun për kryeparlamentare, por ajo nuk ka kaluar në votim të hapur. Vetëvendosja insiston që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë, por opozita e konsideron të papranueshme dhe jokushtetuese. Në mes të këtij ngërçi politik, Gjykata Kushtetuese ka vendosur më 26 qershor që Kuvendi duhet të



Përplasen Musliu - Dehari, ndërpritet seanca për konstituimin e Kuvendit

Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, e ka ndërprerë të mërkurën seancën e 51-të për konstituimin e Kuvendit pa e hedhur në votim komisionin e fshehtë për zgjedhjen e kryeparlamentarit, pas përplasjes që pati me deputeten e Partisë Demokratike të Kosovës, Ganimete Musliu, e cila kërkoj t’i lejohej vazhdimi i fjalimit në foltoren e Kuvendit. Dehari insistoi që Musliu të lejohej ta vazhdonte fjalimin vetëm nëse kishte propozim për anëtarin e komisionit të fshehtë. Pasi mikrofonin iu ndërpre disa herë radhazi, Musliu u nis në drejtim të Deharit, duke i shkaktuar vështirësi për ta

vazhduar seancën për konstituimin e Kuvendit. Pas këtij veprimi, Dehari kërkoj që seanca të ndërpritej. “Debat në seancën konstituive nuk ka, jo se unë jua ndaloj këtë punë, por rregullorja”, deklaroi Dehari pak para ndërprerjes së seancës. Musliu sërish reagoi, duke thënë “nëse keni vetëm pak moral dhe integritet njerëzor, të lutem përmbyju”. Dehari ia ndërpreu sërish mikrofonin, duke kërkuar që Musliut t’i ndërpritej fjala. Ky veprim e shtyu atë të shkonte drejt foltores së kryesuesit të Kuvendit dhe përmes mikrofonit të Deharit, të thoshte “të lutem, mos e ndal mikrofonin”.



Maqedonci takohet me homologun turk, diskutojnë për sigurinë dhe fabrikën e municionit

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije se është takuar me homologun turk Yasar Guler me të cilin ka biseduar për situatën e sigurisë. Maqedonci ka bërë treguar se me ministrin turk ka biseduar edhe për fabrikën e municionit e cila pritet të hapet në Kosovë. “Sot pata nderin të takohem me ministrin Yaşar Guler, një takim produktiv ku diskutuam mbi situatën gjeopolitike aktuale, avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa theksova rëndësinë e

mbështetjes që po marrim nga Turqia. Bashkëbisedimi me ministrin Guler ishte jashtëzakonisht pozitiv gjersa shtjelluam mundësi të reja bashkëpunimi me qëllim ngritjen e kapaciteteve të reja të ushtrisë së Kosovës. E veçanta e këtij takimi ishte diskutimi mbi rolin strategjik që do të ketë Kosova në rajon pas funksionalizimit të fabrikës së municionit. Ky projekt do të rrisë ndjeshëm aftësitë e FSK-së, do të mundësoj vet-qëndrueshmëri logjistike dhe do të kontribuojë në stabilitetin e përgjithshëm të

rajonit. Kosova, duke forcuar strukturat e saj mbrojtëse, do të jetë në një pozicion më të mirë për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe për të ndihmuar në promovimin e paqes dhe stabilitetit. Theksova rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve, duke sjellë në vëmendje se marrëdhëniet tona janë thelbësore për stabilitetin dhe sigurinë në rajon, ndërsa u dakorduam për vazhdimësinë e bashkëpunimit si element kyç, strategjik për sigurinë e rajonit”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”.





Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

NJË MASHTRUESE PËRFITUESE

Yjet që nuk i kishim parë më herët: Kosova është vend i mundësive të mëdha për ish-udbashët jugosllavë, për nostalgjikët e Serbisë, për urrejtësit e luftës së lavdishme të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, për urrejtësit ndaj ish të burgosurve politikë, për bijtë dhe bijat e zagarëve që lehnin shqip e kafshonin serbisht, për llumin njerëzor, kombëtar dhe moral dhe të tjerë të cilët, që nga koha e Car Dushanit nuk kanë bërë asgjë për kombin dhe territorin ku kanë jetuar. Këta sot, për fatin tonë të keq po e “udhëheqin” Kosovën duke shkelur brutalisht mbi vuajtjet shekullore, mundin dhe gjakun e derdhur të shqiptarëve në luftë për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar. Këta të pafytyrë qajnë për mjetet që janë ndarë për mbrojtje të udhëheqësve ushtarakë dhe politikë që e çliruan Kosovën, e shpallën pavarësinë dhe e ndërtuan një infrastrukturë institucionale dhe fizike dhe po mbahen si pengje të proceseve politike në Hagë. Këta po i vajtojnë 32 milionë euro ndërsa kanë vjedhur përmes Martin Strujës, Teneqe Mutatit, Cen Mishit, Baronit të Ujit, HAJNruallahut, Peculkës, vejushës së Panxhabit dhe të tjerëve qindra milionë euro. Këta të pafytyrë, duke kapur pushtetin brutalisht, kanë vendosur persona më antikombëtarë, më të pamoralshëm në vend me përgjegjësi ndonëse puna e parë në jetën e tyre ishte pikërisht posti

që ua fali Kurthi për ta siguruar servilizimin e pariciklueshëm ndaj tij. Kurthi, Vojsa Osmani, Xhelal Sfeqla, Donika Shvarc, Lenka Haxhiu, me alkiminë e tyre antikombëtare ia mundësuan një hiçmosgjëje të shndërrohet nga një person non grata, e rrezikshme për sigurinë e vendit, sipas vlerësimeve të institucioneve të sigurisë në një person alfa dhe omega për të gjitha proceset politike dhe kombëtare në Kosovë sepse në Shqipëri nuk e lejojnë të hyjë as në qenefet e Maqellarës. Në Kosovë nuk ka punësim partiak, tender partiak, emërim partiak, blerje të rrymës, dëmtim të çështjes politike a kombëtare ku kjo ushujzë greke nuk është e pranishme. Prandaj, çfarë motivi kanë këta të bëjnë ndonjë punë të mirë për Kosovën, për shqiptarët jo se jo, përveç që flasin shqip, asgjë shqiptare nuk kanë në mendjen, trupin apo anatominë e tyre. Përveç se në emër të kombit kanë manipuluar për ta marrë pushtetin. Dhe këtu përfundon “kombëtarizmi” i tyre, qoftë edhe si improvizim. Ditë më parë dy ish-jugosllavëve të përkushtuar dhe përбетuar, të cilët asgjë nuk kanë bërë për shqiptarët dhe Kosovën, nëse keqbërja llogaritet bërje apo kontribut, atëherë kontributi i tyre është kolosal, i dhanë të drejtë që të vënë nën dyshim demonstratat e vitit 1981, Masakrën e Tivarit, personalitetin e Bacë Adem Demaçi etj. në një

bullshit emission të quajtur Pordhë dhe Pikë! Jeton Qurroi kundër UÇK- së ka shkruar libra ndërkaq e burgosin një politikan të Serbisë që paska folur keq për UÇK-në! Nuk është normale që serbët të flasin mirë për UÇK-në sikur që nuk është normale që Azem Vllasi dhe Veton Surroi të quhen patriotë shqiptarë, patriotë jugosllav, pa asnjë dyshim janë! Agim Bahtiri, një i padijshëm që nuk mund ta gjeni as në librin e Ginisit, kohëve të fundit, si mizë kali e Kurthit po jep deklarata politike, merreni me mend, politike sikur opozita në Kosovë, me 53 deputetë shqiptarë po punon me Serbinë për ta rrëzuar Kurthin dhe se PDK-ja dhe LDK-ja po bëhen një parti. Pastaj, mos e dërgoni këtë injorant dhe leshko në Shtime, te “Çlirimtari”! Kur ta dëgjoni Nezir Krakovinën atëherë, singërisht duhet ta falënderoni Francën që merret me raste të tilla e që ne, për shkak të mungesës së kapacitetit profesional, nuk do të mund të bënim asgjë! Çka ka fituar Kosova prej Donika Shvarcit përveç turpërimit, anekënd botës, cep më cep, duke përhapur injorancën dhe mediokritetin e mbështjellë me diplomaci. Personalisht Donika Shvarc ka fituar shumë, materialisht dhe estetikisht. Brendinë e ka të pandryshuar, ktratan zi. Këta, me të tjerët e kanë shkatërruar Kosovën, materialisht dhe strategjikisht duke e bërë të pajetuar për pjesën

e madhe të qytetarëve dhe duke e bërë Eldorado (tokë e premtuar) për oligarkët autokratë politikë dhe rrogëtarët e tyre.

Një mashtuese e lakuriquar: Vojsa Osmani, pasi e ndau në dysh LDK-në, partinë që ia krijoi të gjitha mundësitë për ngritje në karrierë, u zgjodh presidente falë votave edhe të Listës Serbe, u shndërrua në vasale kronike të Albin Kurthit, deri në kohën kur Kurthi e futi në ricycle been (shportë të mbeturinave politike), për ta ricikluar, nëse do të ketë nevojë për të. Në anën tjetër, Vojsa Osmani, që më shumë mund të konsiderohet si presidente e Ukrainës sesa e Kosovës, edhe nga “shporta e mbetjeve politike” mbante të gjallë shpresën edhe për një mandat të dytë, të sponsorizuar nga kryemashtuesi Kurthi (po thirrem në burimet e Haradinajt). Vojsa Osmani kohën më të madhe e ka kaluar duke udhëtuar nëpër botë, edhe atje ku nuk ka pasur fare nevojë të shkojë përveç përfitimit material për t’i shlyer faturat përshtëpi në varg në Marigona Hill, lagje kjo shumë modeste për qytetarë që mbijetojnë falë skemave sociale. Ndonëse në raporte “të ngrira” me Kurthin, nuk ka lënë deklarata a veprim pa ia mbajtur zhagun Kurthit, si presidente “unifikuese”. Kjo, po të kishte fuqi apo përkrahje politike, do të bënte gjëra dhe Kurthi do të mbetej një “good boy”, krahasuar me te. Mirëpo nuk e ka asnjë fuqi dhe nuk do ta ketë prandaj

përjetësisht do të mbetet shërbyese civile e të fortëve të pushtetit, dikur e Fatmir Sejdiut dhe Isa Mustafës (që të dyve ua punoi pabesisht), aktualisht e Kurthit (ky u tregua më i mençur). Kur nuk pati çka të bëjë për të mbuluar rrenat për sulmin e Serbisë, madje në vallen e rrenave e futi edhe Trampin, e sulmoi, pa pikë sensi e morali, Avdullah Hotin i cili, krahasuar me Vojsën është katalog i sjelljeve dhe vlerave njerëzore! Vizitat në ShBA ishin mashtrim vizuel për të lënë përshtypje se është “njeri i Amerikës”! Këtë pastaj do ta materializonte për mandat të dytë. Kjo, bashkë me Kurthin gjatë 5 vjetëve të fundit kanë terrorizuar qytetarët duke mbjell frikë për sulmet e Serbisë për të mbuluar dështimet kolosale në të gjitha fushat. Nuk e them se Kurthi, bashkë me Vojsën kanë marrëveshje me Vuçiqin por, nëse analizohet kronologjia e zhvillimeve del se Kurthi dhe Vuçiqi janë “binjakë ballkanik - sijamez” që iu kanë gjetur njëri - tjetrit në çdo kohë dhe në çastet më të ndjeshme. Së fundi, Vojsa Osmani, për herë të dytë iu drejtua Gjykatës Kushtetuese pasi herën e parë e pati bërë fet. Tash, dinakërisht, nuk kërkon kurrfarë sqarimi por thjesht, si rrogëtare e Kurthit blenë kohë për padronin duke kërkuar pezullim të vendimit të mëparshëm me të cilën Gjykata Kushtetuese e cakton afatin prej 30 ditëve për formim të Kuvendit. Merreni me mend, presidentja e

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS: NGA 1 GUSHTI PA ADRESË ZYRTARE S'KA DOKUMENTE CIVILE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Agjencia Kadastrale e Kosovës ka mbajtur të mërkurën konferencë për medie në lidhje me projektin “Ndërlidhja e qytetarit me adresën zyrtare”. Drejtori i kësaj agjencie, Avni Ahmeti, ka njoftuar se nga 1 gushti 2025 qytetarët që nuk e kanë deklaruar adresën zyrtare nuk do të mund të pajisen me dokumente të rëndësishme, përfshirë certifikatën e lindjes dhe të pronësisë. “E dimë që për një pjesë të madhe të njerëzve kjo temë mund të duket thjesht administrative por, në thelb, bëhet fjalë për shumë më tepër: për rend, për të drejta, për qasje më të lehtë në shërbime, për ndërtimin e një shteti më

funksional dhe gjithëpërfshirës. Nga data 1 tetor 2024 kemi filluar zyrtarisht projektin për ndërlidhjen e qytetarit me adresën zyrtare, ku kemi bërë fushatë intensive dhe punë të palodhshme për t'i informuar qytetarët për rëndësinë e këtij procesi”, ka thënë Ahmeti. Ai ka theksuar se me “krenari mund të themi se janë mbi 220 mijë qytetarë që tashmë e kanë bërë deklarinimin e adresës zyrtare”. Drejtori Ahmeti ka bërë me dije se deklarimi mund të bëhet fizikisht në komunë apo online përmes platformës “E-Kosova”. “Qëllimi i kësaj konference është t'i informojmë të gjithë qytetarët që nuk e kanë deklaruar adresën zyrtare, se nga data 1 gusht e këtij viti nuk do të mund të pajisen me dokumentet që lëshohen nga ARC-ja dhe AKK-ja. Për më tepër,



pa deklarimin e adresës zyrtare qytetarët nuk mund të pajisen me certifikatë të lindjes apo certifikatë të pronës. Për ta lehtësuar këtë proces kemi bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë për Regjistrim Civil dhe Agjencinë Shtetërore të Informacionit, dhe kemi mundësuar që deklarimi të bëhet edhe online përmes platformës ‘E-Kosova’. Pra, përveç mënyrës duke u paraqitur fizikisht në zyrat e gjendjes civile, çdo qytetar mund ta bëjë deklarinimin lehtësisht, nga telefoni apo kompjuteri, për vetëm pak minuta”, ka thënë ai. Ndërsa drejtori i Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), Blerim Camaj, ka thënë se të gjithë qytetarëve të cilët nuk kanë adresë të saktë do t'u kushtëzohen shërbimet civile nga 1 gushti.

vendit del mbi Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar që GJK ta pezullojë vendimin e saj duke e dhunuar Kushtetutën të cilën duhet ta mbrojë!!!! Në vende normale dhe gjysmë normale, një presidente e tillë do të shkarkohej menjëherë ndërsa në Kosovë kjo përpjekje për të bërë krim kushtetues konsiderohet si “kontribut për zgjidhje të ngërcit”. Vojsa Osmani, për këtë çështje nuk ka pasur fare të drejtë t'i drejtohet GJK për faktin se ajo ka përgjegjësi për funksionim të institucioneve e jo formim të institucioneve. Kjo është përgjegjësi ekskluzive dhe ligjore e deputetëve të Kosovës, partisë fituese e cila duhet të kërkojë dhe sigurojë konsensus politik. As e presidentes e as e Gjykatës Kushtetuese. Votuesit është dashur të lëvizin duke kërkuar përgjegjësi përmes protestave dhe, po të veprohej kështu, kjo çështje do t'i takonte të kaluarës. Çka ka Gjykata Kushtetuese të merret me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës në kohën kur, si akt nënligjor kur është miratuar ka qenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës!

Fatmiri apo Fatkeqi: Anëtarësia e LV-së, bashkë me korin e llaskucëve gjithëpërfshirës, në me krye prof. dr. Ramçen dhe Togër Tomçen, janë të magjepsur dha

po shprehin respekt dhe dashuri pasionante për Fatmir Limajn - komandant Çelikun, dikur të quajtur Fatmir Asfalti dhe Hajni i 200 milionëve. Madje edhe rrugën ku jetonte e kishin riemëruar “Rruga e 200 milionëve”. Tash, kur po kanë nevojë për tri vota të Fatmir Limajt, iu ra ndërmend se është komandant i shquar i UÇK-së dhe se pa punën e tij vetmohuese, balta do të na ngitej këmbëve, jo vetëm në fshatra të Kosovës por edhe në vet Prishtinën. Tash po mburren me ndershmërinë, largpamësinë dhe integritetin njerëzor, kombëtar, politik dhe moral, sidomos moral të Fatmir Limës. Po e vlerësojnë lartë gatishmërinë e tij prej burrështetasi të sakrifkohet për Kosovën duke u bërë patericë e LV-së dhe Albin Kurthit. Lëvdatat më të mëdha i ka nga Donika Shvarc, Nezir Krakovina, Peculka, Dilmali, Agim Bahtiri, Mef Baçina, HAJNnullahu dhe të tjerët. Rrallë më ka ndodhur që ndaj një partneri të mundshëm për koalicion të ketë përkrahje aq konsensuale sikur në këtë rast. Po e përkrahë edhe Lenka Haxhiu, pasi u sigurua nga zemlakja e Radoiqit se Limaj nuk mund të zgjidhet kryeparlamentar. Pastaj, edhe Kumbara i Kosovës, Albin Kurthi publikisht e tha se Limajt i ka

ofruar një propozim konkret, i cili.....nuk mund të refuzohet. Sikur don Vito Korleone në filmin “Kumbara”. Mirëpo, as Limaj nuk është treguar mosmirënjohës dhe shpërfillës ndaj këtij lumi të emocioneve të derdhur nga lotët e krokodilit të LV-së duke ofruar bashkëpunim të pakushtëzuar, me vetëm një kusht, qeverinë Kurthit, Kuvendin Fatmirit. Tha se kanë arritur “marrëveshje orale xhentelmenësh (xhentelmenët nuk nënshkruajnë) që posti i kryetarit të Kuvendit t'i takojë Fatmir Limajt. Duke e njohur mirë Kurthin asnjëherë nuk kam dyshuar se ai e mbanë fjalën. Kështu edhe ndodhi, Kurthi i ofron Limajt bashkëqeverisje e që, në rastin e parë Limajn e trajton si Agim Velion. Si kryetar Kuvendi nuk mund ta shkarkojë, si pjesë të qeverisë i shkarkon kur të dojë dhe në vend të tyre emëron anëtarë të LV-së. Nuk është se Limaj bien lehtë në kurthin e Kurthit ama pushteti ta humbë baraspeshën dhe arsyeshmërinë e të menduarit. Sidomos kur jeni të rrethuar me ajkën e intelektualëve që udhëhiqet nga Forumi Evropian 2030 në krye eruditin Artan Nimanin. Në tërë këtë proces, u preka shumë, ndoshta edhe jam ligështuar, më duhet të jem i sinqertë më rrodhen edhe lotët

kur Fatmiri, si faktin kryesor për një koalicion të mundshëm nuk e përmendi lakminë për pushtet por faktin se “nuk dëshiron që kryeministri i tij të jetë i mërzhitur ..”. Çka të them pas kësaj?! Realisht, Limaj nuk do të jetë kryetar Kuvendi por mund të jetë pjesë e qeverisë e që për mua do të jetë keq për Fatmirin për faktin se ardhmëria e tij politike do të jetë shkrija në Listën e LV-së, sikur Alternativa dhe Guxo. Ramiz Lladrovci, një njohës i shkëlqyer i zhvillimeve politike në Kosovë, rajon dhe botë, një analist ekselent i ardhshëm politik, menjëherë pas zgjedhjeve pati thënë se Limaj nuk do të jetë kryetar Kuvendi por se sigurisht do të bëhet pjesë e qeverisë Kurthi 3. Ramiz Nostradamusi! I sheh gjërat pa ndodhë, ne të verbëritë informativ nuk i shohim edhe kur të ndodhin. Me formimin e Kuvendit do të ketë shumë fitues, Lenka Haxhiu, pa kredenciale profesionale dhe në kundërshtim me standardin minimal moral mund të zgjidhet kryetare, publiku i gjerë do të kursehet nga bezdisja dhe ngulfatja e “kryekyvdararit marionet”, Avni Deharit”, që i bënë standardit minimal të demokracisë, deputetët që do të mund t'i përdorin telefonat e tyre pasi nuk do të ketë më: “regjia,

ndaljami telefonin ..” Humbësja më e madhe do të jetë Vojsa Osmani që u vonua për çdo gjë për të siguruar edhe një mandat, si notere e përmbaruesit politik, Albin Kurthit. Mos të harrojë, llogaria nuk i doli mirë as Arianit Kocit i cili tha se po e sakrifikon edhe një pjesë të trupit për të mirën e Kosovës dhe njerëzimit, leshin e kokës që quhen flokë dhe sipas anatomisë, flokët nuk janë pjesë e trupit. Sipas Kocit edhe leshi i shpërndarë në pjesët e tjera të trupit qenkan pjesë e trupit apo mbulesë e turpit!

“Shkatërruesit” dhe shkatërruesit e shtetit: Më 26 korrik, ata që i qëndruan Bacës Adem Demaçi afër gjatë tërë kohës do ta nderojnë vendin ku prehet në amshim, sikur çdo vit tjetër. Me një kurorë apo buqetë lulesh kujtohet Abetarja, Kuptimi dhe Akademia e shqiptarëve në luftë për çlirim, liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar, Bacë Adem Demaçi. “Shkatërruesit” e shtetit që e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë dhe e ndërtuan shtetin do të mungojnë, janë pengje të një Gjykate Speciale Raciste në Hagë. Shkatërruesit real dhe të mirëfilltë të shtetit do të jenë aty, disa me tërë pafytyrësinë e tyre për faktin se tërë jetën e tyre kanë punuar kundër mësimave të Bacës Adem. Poshtërsia nuk ka kufij.

KQZ-ja miraton kërkesën për ridestininim të buxhetit për zgjedhje

PRISHTINË, 23 KORRIK - Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është miratuar ridestininimi i buxhetit për zgjedhje. Ky ridestininim është miratuar me 6 vota për, dy kundër dhe një abstenim. Disa nga anëtarët e KQZ-së e kanë akuzuar sekretariatit se nuk ka bërë analizë të mirë dhe qeverisë i janë kërkuar para më shumë sesa që duhet. Anëtar i AAK-së në KQZ, Muharrem Nitaj, ka thënë se nuk kanë marrë përgjigje pozitive e as negative nga

qeveria për buxhet. Por, sipas tij, edhe komisioni projektionin e ri buxhetor e ka bërë me shumë vonesë. “Tani komisioni e bën një projektion tjetër buxhetor dhe e bën me shumë vonesë. Unë nuk i kontestoj analizat e tij për ridestininim të mjeteve në shtylla të caktuara, por konsideroj se nuk ka qenë punë e realizuar siç duhet”, ka thënë ai. Ndërsa anëtar i LDK-së në KQZ, Sami Hamiti, ka thënë se kërkesat e tyre kanë qenë të vazhdueshme, duke akuzuar sekretariatit e këtij institucioni

se nuk ka bërë fare analizë. Më tutje, anëtar i PDK-së në KQZ, Ilir Gashi, ka thënë se çështjen e buxhetit e ka ngritur një muaj më herët. “Unë çështjen e buxhetit e kam ngritur që një muaj dhe sa i përket kërkesës sonë që ia kemi dërguar qeverisë, për të cilën nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Pse është dashur të pritët 30 ditë për të ardhur te ridestininimi i buxhetit. Kërkesa është mbi 6 milionë euro. Ia keni huq në kërkesa a? Këtu duhet dhënë përgjigjësi”, ka thënë ai.



Kurse anëtar i LV-së, Alban Krasniqi, ka thënë se teprica apo buxheti të cilin nuk kanë

mundur ta realizojnë gjatë vitit 2024 është rreth 2 milionë euro.

AGK-ja shpreh shqetësim lidhur me situatën financiare në RTK

PRISHTINË, 23 KORRIK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka shprehur shqetësimin me zhvillimet që lidhen me transmetuesin publik të Kosovës, RTK. Paralajmërimi se brenda pak

ditësh RTK-ja do të mbetet pa financim dhe nuk do të jetë në gjendje t'i paguajë të punësuarit e saj për muajin korrik është alarmues. AGK-ja e njeh rolin e rëndësishëm që luan

Transmetuesi Publik në skenën mediale të Kosovës dhe në mungesë të Kuvendit funksional bën thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për vazhdimin e financimit të RTK-së. "Gazetarët,

kameramanët dhe stafi tjetër i RTK-së duhet të jenë në gjendje që të bëjnë punën e tyre në mënyrë të papenguar nga presione politike apo financiare", thekson AGK-ja në reagimin për medie.



RASTI I AGON ZEJNULLAHUT: GJYKATA VENDOS PËR RIKTHIMIN E 5 POLICËVE NË PARABURGIM

PRISHTINË, 23 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, vendosi që t'i kthejë në paraburgim pesë zyrtarët policorë që dyshohen për veprën penale "vrasje nga pakujdesia" të 27-vjeçarit Agon Zejnullahu. Rasti ishte në rigjykim nga 21 korriku, me kërkesë të mbrojtësve të tyre. Në aktvendimin e fundit të Gjykatës Themelore thuhet se të dyshuarve u caktohet masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji dhe se ajo do të llogaritet prej datës së ndalimit të tyre, më 7 korrik 2025, deri më 6 gusht 2025. Aty, po ashtu, thuhet se "pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së paraburgimit dhe pas vlerësimit të kundërshtimeve dhe argumenteve të të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre", ka "arsye të mjaftueshme

që të pandehurve t'u caktohet masa e paraburgimit". Zejnullahu ka vdekur në orët e para të 7 korrikut, pasi është arrestuar nga policia në Lipjan. Vdekjen e tij në vendngjarje e ka konstatuar edhe ekipi mjekësor. Policia ka thënë se i ndjeri dyshohet se ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe kur është ndaluar nga autoritetet e rendit ka qenë duke sulmuar automjete dhe kalimtarë. Por, sipas familjarëve dhe avokatit të tij mbrojtës, policia ka përdorur forcë të tepruar kundër tij. Kështu kanë thënë edhe disa përfaqësues të shoqërisë civile, pasi kanë parë disa pamje që janë publikuar në internet. Komandanti i policisë për rajonin e Lipjanit, Argjend Gashi, ka dhënë dorëheqje pas vdekjes së Zejnullahut.



LATIFI NËNSHKRUAN KONTRATËN PËR ASFALTIMIN E RRUGËS ME GJATËSI PREJ 22 KILOMETRASH



RAHOVEC, 23 KORRIK - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar kontratën me "Lika Company Sh.PK." për projektin e asfaltimit dhe të përmirësimit të infrastrukturës rrugore në komunën e Rahovecit me gjatësi prej 22 kilometrash. Latifi ka thënë se ky projekt përfshin dy segmente rrugore: Rahovec - Drenoc - Senoc - Pastasel - Polluzhë - Sarosh dhe segmentin tjetër nga Drenoci në drejtim të Pataqanit të Epërm e të Poshtëm deri në Fortesë, duke përfshirë edhe rrethrotullimin mes Sapniqit dhe Fortesës. "Në projekt përfshihet: riasfaltimi dhe zgjerimi i rrugës, vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal, si dhe ndërtimi i

mureve mbrojtëse me standarde moderne. Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 3.863.123.57 euro dhe realizimi i tij po bëhet përmes bashkëfinancimit me Ministrinë e Infrastrukturës, të cilën e falënderoj për mbështetjen! Për shkak të temperaturave të larta dhe në përputhje me vendimin e Ministrisë që ndalon asfaltimin gjatë valës së të nxehtit, fillimisht do të bëhet organizimi dhe mobilizimi në terren, ndërsa shumë shpejt do të fillojmë edhe me realizimin konkret të punimeve. Ky investim do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e lëvizjes dhe të lidhjes mes vendbanimeve", ka thënë kryetari Latifi.

Funksionalizohen recepsionet në bllokun e klinikave kirurgjike

PRISHTINË, 23 KORRIK - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar se për të

qenë sa më afër me pacientët dhe familjarët e tyre janë funksionalizuar recepsionet në

bllokun e klinikave kirurgjike. "Përmes këtyre investimeve, lehtësuam qasjen dhe marrjen

e informacioneve për pacientët që trajtohen në këto klinika", ka njoftuar ShSKUK.



KADRI VESELI, SHTYLLË E REZISTENCËS, LIRISË, SHTETNDËRTIMIT DHE DINJITETIT KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Përrulje për patriotizmin e tij të rrallë, përkushtimin e palëkundur ndaj shtetit dhe vlerave të lirisë së popullit shqiptar në Kosovë

Shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA
(Ekspert i së Drejtës Publike)

Në udhën historike të popullit shqiptar të Kosovës - një udhë e përgjakur, por e mbushur me dinjitet dhe krenari - emri i Kadri Veselit zë vend të veçantë në panteonin e figurave që nuk e kanë kursyer as jetën, as lirinë personale, as përfitimet individuale për hir të një ideali më të madh: çlirimit, pavarësisë dhe shtetformimit të Republikës së Kosovës. Ai nuk është thjesht një emër në listën e liderëve institucionalë të pasluftës; ai është një dëshmi e gjallë e vijmësisë historike të një ideali kombëtar të nisur me breza e përmbushur me sakrificë.

1. Nga rezistenca në çlirim, një rrugëtim historik i përfaqësuar me dinjitet

Kadri Veseli i përket brezit të atdhetarëve që nuk pranuan realitetin e robërisë dhe as simulimin e "autonomisë" nën strukturat represive serbe të viteve '80 e '90. Në vend të pajtimit me gjendjen, ai u rreshtua me ata që besonin se liria nuk dhurohet, por fitohet me përgatitje, sakrificë dhe organizim. Si një ndër themeluesit dhe drejtuesit e Shërbimit

Informativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (SHIK-ut) - një strukturë thelbësore në funksionimin e UÇK-së - ai kishte rol strategjik në ndërtimin e inteligjencës ushtarake dhe mbrojtjen e vijës së parë të luftës, ndërkohë që sigurohej rrjeti logjistik dhe politik në arenën ndërkombëtare. Në këtë fazë, Kadri Veseli nuk ishte vetëm drejtues i padukshëm i një segmenti inteligjence: ai ishte koka menduese e një mekanizmi që i dha Kosovës fuqinë për t'i qëndruar përballë një makinerie kriminale si ajo e shtetit serb. Në vetëdijen historike të çdo shqiptari të Kosovës, kjo fazë përfaqëson epokën e rilindjes kombëtare moderne, ku figura të tilla si Veseli janë ngulitur si prijës të mendimit strategjik dhe organizimit efikas të rezistencës.

2. Nga lufta në paqe, arkitekt i shtetit dhe i institucioneve të Republikës

Me përfundimin e luftës dhe fillimin e fazës së ndërtimit të paqes, Kosova kaloi në një periudhë të ndërlikuar politike dhe institucionale. Ndërkohë që shumë kush zgjedhi të tërhiqej në heshtje ose të shfrytëzonte ndikimin e pasluftës për interesa personale, Kadri Veseli vazhdoi të mbetet këshilltar, strateg dhe më vonë lider institucional, gjithnjë

në funksion të interesit publik dhe konsolidimit të shtetësisë. Në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (2014 - 2019), Veseli përfaqësoi një qasje moderne, euroatlantike dhe shtetformuese në udhëheqjen politike të institucioneve. Ai respektoi me përpikëri parimin e ndarjes së pushteteve, duke ruajtur integritetin e Kuvendit si qendër sovraniteti dhe platformë e pluralizmit demokratik. Në të njëjtën kohë, ai mbeti një zë unik në konsolidimin e subjektivitetit të jashtëm të Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare - duke qenë përherë i besueshëm në raport me aleatët perëndimorë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Veseli përfaqësoi një politikë të përgjegjshme dhe jo hakmarrëse, që synonte bashkimin e faktorit të brendshëm politik rreth prioritetëve të mëdha shtetërore: njohjen ndërkombëtare, integrimin euroatlantik, zhvillimin ekonomik dhe forcimin e rendit kushtetues.

3. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia e matur e një shtetari vizionar

Në dimensionin diplomatik, Kadri Veseli u paraqit gjithnjë si përfaqësues i Kosovës moderne dhe demokratike - i një shteti që aspirojnë të jetë kontribuues i

paqes dhe stabilitetit në Ballkan dhe Evropë. Ai artikuloi me qartësi pozicionet e Kosovës në tryeza ndërkombëtare, gjithnjë i përkushtuar ndaj narrativës së drejtë historike, por pa rënë në retorika folklorike ose ideologjike që do ta marginalizonin pozitën e shtetit të ri.

Në mënyrë të veçantë, Veseli ka qenë një nga zërat më të fuqishëm në mbrojtjen e partneritetit me NATO-n dhe ShBA-në, duke e konsideruar këtë bosht si garanci për paqe të qëndrueshme, integrim dhe siguri kombëtare. Ai e kuptonte më mirë se shumica rëndësinë e gjeopolitikës moderne dhe rreziqet e tentativave për të relativizuar të vërtetën e luftës së Kosovës përmes skenarëve të barazimit moral ndërmjet agresorit dhe viktimës.

4. Përballja me drejtësinë ndërkombëtare, nderi i burrështetasi dhe besimi në të drejtën

Në fazën më të ndjeshme të karrierës së tij politike, Kadri Veseli u përball me aktakuza të ngritura nga Dhomat e Specializuara në Hagë - një proces i ndjeshëm për opinionin publik dhe vetë strukturën morale të shtetit të Kosovës. Por, për dallim nga shumë liderë të rajonit që përdorën pozitën për të

shmangur drejtësinë ose për të nxitur destabilizim, Veseli zgjodhi rrugën e dinjitetit dhe përgjegjësisë, duke u dorëzuar vullnetarisht, pa asnjë përpjekje për të ndikuar në procesin gjyqësor.

Ky akt i tij nuk ishte thjesht një akt ligjor - ishte një akt moral dhe patriotik. Ai e bëri këtë jo sepse ndjeu faj, por sepse besonte në drejtësinë si vlerë universale dhe në nevojën për të mbrojtur imazhin e shtetit të Kosovës si një shtet që respekton drejtësinë ndërkombëtare.

5. Figura e Veselit në kujtesën historike të Kosovës, një model për gjeneratat e reja

Në rrafshin historik, Kadri Veseli mbetet një figurë unike që i bashkon tri epoka: atë të rezistencës, atë të çlirimit dhe atë të shtetndërtimit demokratik. Ai nuk është mit, por është shembulli më i afërt i një lideri që ka kaluar të gjitha fazat e sakrificës, drejtimit dhe përgjegjësisë publike, pa u ndotur nga korrupsioni moral, hakmarrja primitive apo shfrytëzimi i pushtetit për interesa personale.

Për të gjitha këto arsye, Kadri Veseli duhet të zërë vendin që i takon në narrativën e historisë sonë kombëtare dhe në kujtesën institucionale të Republikës. Figura të tilla nuk duhet të harrohen, por të ruhen si kolonat morale dhe strategjike të shtetësisë së Kosovës.

Me përrulje dhe nderim të thellë kombëtar

Kadri Veseli është dhe mbetet një ndër figurat më të rëndësishme të shtetësisë së Kosovës - jo për shkak të postit që ka mbajtur, por për shkak të peshës që ka pasur në të gjitha momentet kyçe të historisë së re shqiptare. Ai është njeriu që nuk u ndal para frikës, nuk u mposht nga kompromiset dhe nuk u përkul përballë padrejtësive. Ai është zëri i Kosovës që kërkon drejtësi, që mbron lirinë dhe që ndërton shtet - edhe nga bankat e luftës, edhe nga foltorja e Kuvendit, edhe përballë çdo sfide ndërkombëtare.

Nderim për veprën e Kadri Veselit, figurës historike që bashkon guximin e luftëtarit, urtësinë e shtetarit dhe besnikërinë e shqiptarit ndaj tokës së vet.

Republika e Kosovës i detyrohet shumë këtij burri. Historia do t'ia japë vendin që i takon. Shkruar me vetëdije historike, ndjeshmëri diplomatike dhe përkushtim ndaj të vërtetës kombëtare.

Talat Xhaferi viziton AKB-në, vlerëson rolin e saj si urë lidhëse mes komuniteteve të biznesit

PRISHTINË, 23 KORRIK - Drejtues të Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) kanë pritur në Prishtinë Talat Xhaferin, ish-kryeministër dhe ish-kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Xhaferi është pritur nga kryetari i AKB-së, Agim Shahini, dhe

anëtari i kryesisë, Shkëlzen Jusaj. Gjatë takimit është zhvilluar një diskutim i hapur mbi mundësitë për zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, me synim krijimin e kushteve më të favorshme për bizneset nga të

dyja vendet. “Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë potencial të madh për ta thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar. Roli i AKB-së si urë lidhëse në mes të komuniteteve të biznesit është i pazëvendësueshëm”, u shpreh Talat Xhaferi gjatë takimit.

Nga ana tjetër, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka theksuar se AKB-ja mbetet e përkushtuar që përmes partneriteteve rajonale ta lehtësojë lëvizjen e mallrave, investimeve dhe ideve, duke krijuar më shumë mundësi për zhvillim ekonomik dhe punësim.



KUSHTET MË TË KËQIJA PËR PUNË NË EVROPË, KU POZICIONOHET KOSOVA?

PRISHTINË, 23 KORRIK - Një ekonomist francez ka kritikuar së fundmi kushtet e punës në vend, duke nxitur debat në Francë. Euroverify hedh një vështrim mbi të dhënat që qëndrojnë pas këtyre pretendimeve. Përdoruesit e rrjeteve sociale në Francë kanë reaguar ndaj deklaratave të bëra së fundmi në televizion nga ekonomisti Jean-Claude Delgenes, i cili tha se Franca ka “mbetur plotësisht pas për sa iu përket kushteve të punës”. “Në një studim të realizuar në fund të vitit 2021 dhe të publikuar më 2022, Franca renditet në vendin e 36, në fund të listës bashkë me Shqipërinë, për sa iu përket kushteve të punës”, deklaroi Delgenes për Public Senat, kanali zyrtar televiziv i dhomës së lartë të Parlamentit francez. Deklaratat e tij kanë nxitur një lumë reagimesh në rrjetet sociale, transmeton Telegrafi. Kjo ndodhi në një kohë kur çështja e kushteve jo të mira të punës është bërë temë e nxehtë në Francë. Gjatë dy muajve e gjysmë të fundit, pesë punëtorë të rinj dhe praktikantë të moshës nga 15 deri në 19 vjeç kanë humbur jetën në aksidente në vendin e punës, duke ngritur pikëpyetje mbi kushtet e punës në vend.

Euronews hodhi një vështrim më të afërt mbi të dhënat për t'i verifikuar pretendimet e Delgenes.

Franca mbetet prapa shumicës së vendeve të tjera evropiane, ku gjendet Kosova?

Këto pretendime bazohen në një studim të vitit 2021 nga Eurofound, një agjenci me seli në Dublin që kryen kërkime mbi kushtet e jetesës dhe punës në vendet evropiane. Analiza e tyre më e fundit mbi kushtet e punës në Evropë, e njohur si EWCS, daton nga viti 2021. Pritet që rezultatet e përditësuara nga terreni për vitin 2024 të publikohen më vonë gjatë këtij viti. Kërkimi analizon kushtet e punës në 36 vende evropiane, duke përfshirë të gjitha 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në studim përfshihet një “indeks i cilësisë së punës”, që kombinon të dhëna mbi aspekte të ndryshme si shëndeti, siguria, kënaqësia në punë dhe të tjera, për ta matur nivelin e stresit që punonjësit përjetojnë në vendin e punës. Rezultatet sugjerojnë se më shumë punonjës në Francë janë



të ekspozuar ndaj kushteve “jashtëzakonisht stresuese” ose “shumë stresuese” sesa në shumicën e vendeve të tjera. Sipas këtyre gjetjeve, vetëm në Serbi, Mal të Zi, Sllovaki dhe Poloni ka më shumë punonjës që punojnë nën kushte “jashtëzakonisht stresuese” ose “shumë stresuese” sesa në Francë. Ndërkohë, Kosova pozicionohet më mirë duke u renditur në vendin e 10. Kosova ka një përqindje shumë të vogël të ngarkesës ekstreme,

ashtu si shumica e vendeve të tjera të përfshira në analizë. Ndërsa në segmentin e ‘ngarkesës së lartë’, vendi ynë renditet proporcionalisht me shtete të tjera si Spanja, Mali i Zi, Italia dhe Suedia. Kur marrim parasysh edhe ata që kanë përmendur kushtet “me ngarkesë të moderuar”, Franca renditet para fundit, me vetëm Sllovakinë që ka rezultat më të keq dhe Shqipërinë që paraqitet pak më mirë. Kështu, kërkimi nuk e vendos Francën “drejt fundit, bashkë me

Shqipërinë për sa iu përket kushteve të punës”, siç pretendon Delgenes. Kur shikojmë vetëm punëtorët që përmendin “ngarkesë ekstreme” ose kushtet më të rënda, Franca renditet në vendin e 30, mbi shtete të tjera anëtare të BE-së si Kroacia dhe Qiproja, si dhe mbi Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, të dhënat vendosin Francën prapa shumicës së vendeve të tjera evropiane kur bëhet fjalë për kushtet e punës. Të dhënat e siguruara nga Eurostat, zyra statistikore e BE-së, konfirmojnë këtë trend. Sipas vlerësimeve të fundit, vetëm Malta renditet më keq se Franca për sa i përket numrit të aksidenteve fatale në vendin e punës. Këto shqetësime janë rritur kohët e fundit me vdekjen tragjike të pesë punëtorëve të rinj në vendin e tyre të punës brenda vetëm dy e gjysmë muajve. Sipas vlerësimeve, dy persona vdesin çdo ditë në vendin e punës në Francë. Qeveria franceze po shqyrton një propozim për t'i ndëshkuar punëdhënësit përgjegjës për problemet në vendin e punës përmes gjobave dhe ndjekjeve penale, sipas një dokumenti që së fundmi e kanë parë mediet franceze, përfshirë edhe “Le Monde”.

BIE NUMRI I PËRFITUESVE NGA NDIHMA SOCIALE



PRISHTINË, 23 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin qershor 2025. Në muajin qershor 2025, krahasuar me muajin qershor 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalide (-21,4 %); skema për pensionet e Trepçës (-20,4 %); skema e ndihmës sociale (-12,9 %); skema për pensionet familjare (-8,5 %); skema për familjet e

dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-2,2 %); skema e p e n s i o n e v e kontributpaguesve të moshës (-1,9 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (-0,6 %); skema për veteranët e luftës (-0,2 %). Në muajin qershor 2025, krahasuar me muajin qershor 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (12,1 %); skema për përkrahje financiare

familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11,4 %); skema e pensioneve bazë të moshës (5,5 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (5,4 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (3,8 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2 %).

Ministri Peci thotë se domatja e Kosovës kap tregjet ndërkombëtare

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se nga 72 mijë në 11 milionë euro, domatja e Kosovës kap tregjet ndërkombëtare. “Në vitin 2021 eksporti i domates ishte vetëm 72 mijë euro. Në

vitin 2024 ka arritur në 11 milionë euro! Një rritje e jashtëzakonshme që tregon suksesin e bujqësisë vendore dhe fuqinë e prodhimeve tona për të konkurruar jashtë vendit. Ndërsa në total, eksporti i

perimeve është rritur 66.9 % krahasuar me periudhat e mëparshme të qeverisjes: 2017-2020: 24.7 milionë euro dhe 2021-2024: 41 milionë euro. Kjo është dëshmi që mbështetja për fermerët, investimet në

infrastrukturë, serat moderne dhe qasja strategjike në tregjet e jashtme po japin rezultate reale. Kosova nuk është vetëm konsumatore, është prodhuese dhe eksportuese!”, ka shkruar Peci në “Facebook”.



NOSTALGJIA - PSE GEN Z ËSHTË MAGJEPSUR PAS 1999-ës?

Çfarë e ka ushqyer këtë fiksim nostalgjik me Y2K?



Ndonjëherë është e vështirë të besohet që ndërrimi i mijëvjeçarit ndodhi një çerek shekulli më parë. Në shumë kuptime, jeta atëherë ndihej shumë ndryshe—interneti ishte ende në fillesat e tij, telefonat përdorehin për të bërë telefonata dhe “X” ishte thjesht një shkronjë në alfabet. Ishte një epokë përpara telefonave të mençur dhe rrjeteve sociale, përpara se të fillonte “lufta kundër terrorit”, dhe ekonomitë globale nuk ishin prekur ende nga kriza financiare.

Ato ditë duken shumë larg, dhe megjithatë Y2K ka parë një rikthim të fuqishëm mes gjeneratave të reja. Qoftë në modë, filma, televizion apo muzikë, shumë njerëz nga Gjenerata Z (ata të lindur mes viteve 1997 dhe 2012) po i rikthehen asaj epoke dhe po e bëjnë përsëri trendin e momentit. Rikthehen këtë verë filma të rinj nga seritë si Happy Gilmore,

Jurassic Park dhe Freaky Friday, ndërsa seriale të dashura si Friends dhe The O.C. tërheqin shikues më të rinj në platformat e transmetimit online.

Muzika nga ajo epokë po kthehet gjithashtu në preferenca, me këngën e Nirvana “You Know You’re Right” që shfaqet në The Last of Us, grupin britanik Oasis që mban koncerte ribashkimi në stadione të mbushura plot dhe grupin amerikan Creed, hiti i të cilëve “Higher” është bërë përsëri i preferuar në aktivitete sportive, dhe do të jetë kryefjala e serisë së koncerteve Summer of ’99 and Beyond Cruise pranverën e ardhshme.

Markat e modës që lidhen me fillimin e viteve 2000—si Von Dutch dhe Ed Hardy—janë bërë sërish pjesë e domosdoshme, kapëset për flokë në formë fluturë dhe syzet e vogla janë të kudogjendura, dhe grimet me ngjyra të forta janë rikthyer. Madje edhe Tamagotchis—kafshët dixhitale të vogla të

fëmijërisë Y2K—janë kthyer, duke i kthyer çantat e shpinës së Gen Z në kapsula nostalgjie të fillim-shekullit.

Në të njëjtin valë, Britney Spears ka gjetur një popullaritet të ri mes Gen Z gjatë viteve të fundit, duke e arritur kulmin këtë maj, kur The Singles Collection qëndroi shumë javë në renditjen e albumeve në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjenerata X mund të jetë një grupim relativisht i vogël krahasuar me popullatat më të mëdha të baby boomers dhe millennial-ëve, por ndikimi i kohës së tyre të artë ka kapur imagjinatën e Gen Z. Raven Baker, përgjegjës për çështje sociale dhe komunitare në Adolescent Content, që studion zakonet e Gen Z, i tha Newsweek se për këtë brez që jeton në mënyrë të vazhdueshme në një botë dixhitale, ka diçka të re dhe të arritshme tek Y2K.

“Mendoj se është pjesërisht një formë arratisjeje, sepse ata

mund të shpërqendrohen nga shqetësimet e sotme, qofshin ato shkolla, punë, miqësi apo prindër. U lejon të zhyten në diçka që është kaq ndryshe nga e sotmja,” – thotë Baker.

A ishte jeta më e mirë atëherë?

Një raport i Shoqatës Amerikane të Psikologjisë zbuloi se të rinjtë janë të mbingarkuar nga stresi, dhe shumë prej tyre pohojnë se përjetojnë nivele stresi shumë më të larta sesa brezat e mëparshëm. Pra, a është për t’u habitur që duan të kthehen pas në atë që duket si një kohë më e thjeshtë?

Ndihmon edhe fakti që shumë prej gjërave ikonike të asaj epoke janë lehtësisht të arritshme sot—qoftë seriale të tëra në platformat streaming, apo foto të famshme të asaj kohe që bëhen virale në TikTok. Lily Todos (@lilytodos) ndan veshje të frymëzuara nga vitet

2000 dhe ripërkthen skena ikonike nga filmat në platformë. Todos, 25 vjeçe, nga Mbretëria e Bashkuar, i tha Newsweek se moda “retro” është bërë një “formë arratisjeje” për të, sepse bota dukej si një “vend më i mirë atëherë” – stilet e modës ishin më të ndryshme, cilësia ishte më e mirë dhe njerëzit “po jetonin jetën e vërtetë,” gjë që krijonte ndjenjën e vërtetësisë, tha Todos.

Gjenerata Z është rritur në një epokë të rrjeteve sociale, ku çdo hap që bëjnë kapet dhe ndahet për një audiencë. Sipas mendimit të Baker, ata ndjejnë mall për një kohë kur njerëzit mund të bënin gabime dhe të eksperimentonin pa frikën se do të bëheshin virale, apo edhe më keq, që do të “asgjësoheshin” nga publiku.

“Mendoj se ekziston një dëshirë për të qenë të çliruar, për të mos u ndjerë të gjykuar dhe për të mos e pasur çdo veprim të regjistruar përgjithmonë në gjurmët dixhitale të dikujt,” tha

Baker.

“Po jetojmë në një epokë mbikëqyrjeje, ku edhe miqtë mund të të monitorojnë dhe të shohin çfarë po bën. Nëse dikush të kap duke bërë diçka të keqe, instinkti është ta postojë online. Ndërsa njerëzit e shijojnë fillimin e viteve 2000 sepse atëherë nuk kishte fare nga këto gjëra.”

Ndërsa gjeneratat e reja e shohin periudhën Y2K përmes filtrit të mediave, është e lehtë të romantizohet dhe ndoshta të zbukurohen ato vite. Por ajo kohë nuk ishte vetëm xhinse të ulëta, sandale xheli dhe takime për kafe në Central Perk.

Ben Lisle, profesor i asociuar i studimeve amerikane në Colby College në Maine, është i kujdesshëm që të mos fshihen vështirësitë e asaj kohe. Ai i tha Newsweek se të shikosh fillimin e viteve 2000 si një epokë të artë do të nënkuptonte një “fshirje historike” të asaj që po ndodhte realisht.

Para vitit 2000, kishte shumë pritshmëri rreth asaj që do të sillte ndërrimi i mijëvjeçarit, dhe ndonëse ai solli përparime teknologjike – si iPod-i në 2001 dhe Facebook-u në 2004 – ishte gjithashtu një kohë e errët për shumë njerëz. Jetët u ndryshuan përgjithmonë nga lufta kundër terrorizmit pas 11 shtatorit, cunami në Oqeanin Indian në dhjetor 2004, dhe uragani Katrina në 2005, përpara se kriza financiare globale e dhjetorit 2007 të çonte në Recesionin e Madh.

Lisle i tha Newsweek se shpesh është “i habitur nga sa pak” dinë studentët e tij për ngjarje kaq të mëdha historike.

Për Lisle, ky është një shembull i konceptit të filozofit Fredric Jameson për pastiche-in, që i referohet imitimit dhe kopimit që nderon stilet apo gjuhën e së kaluarës. Lisle argumenton se ne jemi bërë disi të shkëputur nga e kaluara dhe lidhja jonë me të “është shndërruar në një stilizim të zbrazët.”

Çfarë tregon kjo për shoqërinë e sotme?

Ashtu si brezat që erdhën para tyre, Gjenerata Z po mëson të orientohej në botë dhe po përpiqet të kuptojë çfarë të ardhmeje dëshiron. Por, ndryshe nga paraardhësit, ata po e bëjnë këtë në një epokë të mbingarkesës me informacion, me barrën e rrjeteve sociale dhe inteligjencës artificiale.

Ndërkohë që shëndeti dhe financat janë shqetësimet kryesore për të rinjtë, ata gjithashtu po përballen me shqetësime për sigurinë personale, të drejtat e njeriut, vetminë dhe ndryshimet klimatike, ndërsa ankthi dhe depresioni janë ndër problemet më të përhapura të shëndetit mendor, sipas Institutit Kombëtar të Shëndetit në SHBA.

As kur shikojmë drejt të ardhmes nuk është më mirë – më shumë se gjysma e njerëzve mendojnë se ëndrra amerikane

nuk është më e mundur, sipas një sondazhi të ABC/Ipsos.

A duhet të çuditemi që të rinjtë shpenzojnë kaq shumë kohë duke parë nga e kaluara?

Shumë nga kërkimet që Baker ka bërë për Adolescent Content kanë treguar se Gjenerata Z vuan nga “ankth i lartë”, që shkakton mungesë të theksuar besimi në vetvete. Të mos ndihesh i sigurt për atë që je, kjo i bën të tërhiqen drejt së kaluarës, sugjeron Baker.

Ajo i tha Newsweek: “Kjo gjeneratë ka qenë gjithmonë online. Ata ishin foshnjat e iPad-it dhe kishin smartphone që në moshë të vogël. Të qenët gjithmonë online krijon mungesë vetëbesimi, sepse gjithmonë po e krahasojnë veten me të tjerët. Si mund të gjesh individualitetin tënd të vërtetë nëse je vazhdimisht duke pyetur ‘Kush jam unë në të vërtetë?’”

Megjithë ndikimet negative, 36% e adoleshentëve amerikanë thonë se kalojnë shumë kohë në rrjete sociale, dhe 54% thonë se do ta kishin të vështirë të hiqnin dorë prej tyre, sipas një sondazhi të Pew Research Center.

Gjenerata Z jo vetëm që është rritur online, por ata janë rritur edhe në një kohë të “kulturës së anulimit” (cancel culture). Sipas Baker, kjo shënon një ndryshim të rëndësishëm që ka futur frikën mes të rinjve se mos ekspozohen apo gjykohen publikisht. “Gjatë pandemisë, kur të gjithë ishin mbyllur brenda dhe shikonin njerëzit që dënoheshin publikisht, pushoheshin nga puna apo turpëroheshin online, u dha një mesazh i qartë për Gen Z: Mos e thuaj mendimin tënd të sinqertë dhe mos u trego i hapur me të tjerët në internet,” thotë Baker.

Pse kaq shumë magjepsje?

Todos sigurisht që nuk është e vetmja që ka krijuar një numër të madh ndjekësish në rrjetet sociale duke rikrijuar stile nga vitet 2000. Në fakt, hashtag-u #Y2K ka më shumë se 4.1 milionë postime vetëm në TikTok.

Ajo që Todos pëlqen më shumë te rrobat e asaj kohe është detajimi (si shkëlqimi, rruazat dhe diamantet). Ajo i tha Newsweek se mendon që tani njerëzit po kërkojnë “më shumë detaje në veshjet e tyre”, pas shumë vitesh minimalizmi.

Rikthimi i stileve Y2K nuk është edhe aq i habitshëm, sipas historianit të modës dhe autorit Robert Ossant, që shpjegon se tendencat shpesh përsëriten çdo 20 vjet. Ajo që e bën këtë trend kaq të kapshëm është ndoshta prirja për të idealizuar të afërmen, por edhe paralelizmat mes asaj kohe dhe sot.

Ossant i tha Newsweek: “Fillimi i viteve 2000 ishte një periudhë



optimizmi dhe ankthi për shkak të teknologjive në zhvillim. Sot, me inteligjencën artificiale, njerëzit ndihen njësoj – a do të ndihmojë teknologjia në ndërtimin e karrierës apo do të krijojë një të ardhme ku të rinjtë do të jenë të tepërt? Stilet dhe ankthi janë të njëjtë.”

“Të gjitha tendencat që rikthehen luajnë me nostalgjinë, kështu që gjeneratat e reja e shohin Y2K me sy idealist. Ata mund ta preferojnë atë epokë më shumë sesa kohën e tyre dhe përpiqen ta jetojnë përmes stilit të veshjes”, vazhdon ai.

Ossant beson se moda Y2K ka origjinën, nga stilisti Marc Jacobs në vitin 1992 te Perry Ellis. Ai mbështeti stilin rinor dhe u frymëzua nga grunge-i. Shumë shpejt, moda e rrugës filloi të ndikonte edhe pasarelat, pasi siç tha Ossant, ai e çoi kulturën të rinjve “nga skajet në qendër”.

Nuk kishte më të bënte vetëm me atë që të pasurit po vishnin. Ndërsa dinamika vazhdoi të evoluonte në fillimin e viteve 2000, moda kishte të bënte tërësisht me atë drejt të cilës të rinjtë po gravitonin.

“Stili ishte: bëhu i madh ose shko në shtëpi – ngjyra të forta, orë plastike të mëdha, pantallona të fryra parachute me bluza pa mëngë. Ata zinin hapësirë dhe shfaqnin vetëbesim të lartë,” – tha Ossant.

Sot, marka si Von Dutch dhe Juicy Couture janë rikthyer dhe janë rikonfirmuar si emra të rëndësishëm në modë.

Miss Sixty, e njohur për pantallonat capri dhe kombinimet me xhinse të dyfishta, zgjodhi supermodelen Bella Hadid si fytyrën e linjës pranverë/verë 2025 – një sukses i madh për një markë që dukej sikur kishte dalë nga moda.

Ossant sugjeroi se Gen Z po përdor modën nostalgjike për të dërguar një mesazh. “Është Gen Z që kërkon të duket, dhe përderisa ata vazhdojnë të ndihen të shpërfillur, po përqafojnë stilet e zhurmshme Y2K,” thotë Ossant.

Si po e ushqen media këtë fenomen?

Filmat dhe serialet po i ofrojnë gjithashtu brezit Gen Z referenca ikonike nga Y2K, të cilat janë ende të rëndësishme edhe sot. Platformat streaming kanë prezantuar audienca të reja me seriale të vjetra.

Marina Riekkinen, 21 vjeç, është ndikuar fuqishëm nga serialet Gossip Girl dhe Sex and the City nga vitet 2000, duke i thënë Newsweek se i pëlqente fakti që personazhet kishin stilin e tyre unik në atë kohë.

Këto seriale mund të kenë përfunduar, por Riekkinen shpesh rikrijon veshje që do të mbeten gjatë në kujtesë.

Faqja e saj në TikTok (@marinariiekkinen) është e mbushur me kombinime që edhe Serena van der Woodsen do t'i kishte pëlqyer. “Epoka Y2K vinte theksin tek individualiteti, guximi dhe shprehja përmes modës, dhe kjo është ajo që më prek më shumë,” tha influencerja finlandeze.

“Nuk kishte të bënte me përshtatjen, por me dallimin nga të tjerët.”

Një pjesë e tërheqjes së këtyre serialeve është se të rinjtë mund t'i shohin dhe të “shkundin peshën e botës së sotme”, sipas gazetareve të argëtimit dhe ekspertës së kulturës pop, Tatyana Arrington.

Shumë nga fillimi i viteve 2000 reflekton realitetin e Gen Z, duke e bërë atë të duket më i prekshëm dhe më autentik.

Arrington, nga SHBA, thotë:

“Ndërsa mendojnë se bota është kaq e errët dhe ka kaq shumë urrejtje, ata duan të gjejnë pika gëzimi. Ata i shohin këto seriale si premtimin e një të ardhmeje që duhet të ishte e tyrja, por nuk është.”

Ajo nuk beson se është rastësi që Y2K është sërisht në modë. Jo, ajo mendon se është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj “seriozitetit të botës së sotme.”

Ka një dëshirë mes audienrave për të përqafuar fillimin e viteve 2000, dhe kjo nuk vjen vetëm nga përmbajtjet e reja, por edhe nga rikthimi i përmbajtjeve të vjetra. Aktualisht, seriali më i transmetuar në anglisht në Netflix është Wednesday, që bazohet te personazhi gotik nga filmi i vitit 1991 The Addams Family.

Në vitin 2024 u njoftua se komedia shumë e dashur Malcolm in the Middle nga viti 2000 do të ribëhet, ndërsa Freaky Friday, një vazhdim i filmit të vitit 2003, do të dalë këtë verë.

Anne Hathaway gjithashtu po rikthen një nga rolet më ikonike të saj si Princesha Mia në The Princess Diaries 3, më shumë se 20 vjet pas pjesës së parë.

Nëse kjo nuk mjafton, adhuruesit e serialit hit të vitit 2004 Desperate Housewives u gëzuan nga lajmi për një serial të ri spinoff të titulluar Wisteria Lane.

Ashtu si shumë të tjerë, Arrington e adhuron rishikimin e klasikëve dhe kujton “kohët e arta”. Ato janë seriale komode me një arsye, dhe ndonëse Gen Z nuk ka qenë aty në atë kohë, ata e romantizojnë atë përmes këtyre formateve.

“Epoka Y2K ishte e këndshme dhe argëtuese, dhe u jep mundësinë të futen në një botë ku ndihen të mirëpritur dhe të pranuar,” i tha Arrington Newsweek. “Ishte një kohë e gëzueshme, dhe ata thjesht po përpiqen të sjellin një pjesë të saj në botën ku jetojmë sot.” / Newsweek – Bota.al



ASKUSH NUK E NDAL NETANJAHUN, QË DO TA KTHEJË KONFLIKTIN NË NORMË



Nga Ettore SEQUI

Zgjatja e luftës në Gaza dhe bilanci i përditshëm i viktimave civile, në sfidë të hapur ndaj thirrjeve të Papës Leoni XIV, ndaj rezolutave të OKB-së dhe ndaj presioneve ndërkombëtare mbi Netanyahun, befason dhe shqetëson. Sipas Axios, në Uashington po rritet zhgënjimi për sjelljen “jashtë kontrollit” të kryeministrit izraelit, i akuzuar nga Shtëpia e Bardhë se po rrezikon strategjinë amerikane në rajon. Pas kaosit të dukshëm, fshihet një strategji e qëllimshme. Netanyahu nuk vepron me impuls, por shfrytëzon çdo çarje në sistemin ndërkombëtar dhe përshpejton ofensivën në Gaza, para se presionet amerikane për një armëpushim të bëhen të papërballueshme. Çdo javë pa armëpushim, lodhet Hamasi, zhvlerësohet diplomacia dhe konsolidohen faktet e kryera në terren. Dëshpërimi në rritje i

popullsisë palestineze shërben si instrument presioni për një eksod drejt shteteve fqinje që megjithatë refuzojnë t’i presin. Arsyet e strategjisë izraelite ndahen në katër boshte. Së pari, mbijetesa politike: nën proces gjyqësor dhe i braktisur nga disa aleatë, Netanyahu përdor luftën për të forcuar pozicionin e tij. Së dyti, presioni ideologjik: ministrat e tij, eksponentë të së djathtës mesianike, Smotrich, Ben-Gvir dhe kolonët më radikalë, e shohin një armëpushim si të papranueshëm dhe shtyjnë për “pushtimin total” të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Së treti, llogaritje negociatash: çdo ditë lufte e lodh Hamasin, shkatërron infrastrukturën civile dhe shtyn popullsinë palestineze drejt kolapsit, duke forcuar pozitat e Izraelit në negociatën dhe duke ushqyer dëshpërimin në Gaza. Së katërti, mburoja gjeopolitike: Netanyahu e di që vetë SHBA e

mbron nga sanksionet dhe se Trump, edhe pse i irrituar, nuk do të prishë boshtin strategjik. Mbështetja e bazës evangjelike amerikane, besnike ndaj Trumpit, forcon pandëshkueshmërinë e tij. Në përmbledhje: lufta për Netanyahun është mjet pushteti dhe qeverisjeje, jo një emergjencë për t’u zgjidhur. Ofensiva në Rripin e Gazës nuk synon më thjesht neutralizimin e Hamasit, por shpërbërjen përfundimtare të Gazës si një njësi politike, civile, infrastrukturore dhe demografike autonome. Goditja ndaj qendrave humanitare dhe objekteve të kultit, segmentimi i territorit në zona të evakuueshme dhe bllokimi i ndihmave bëjnë pjesë në një doktrinë të shpërbërjes së qëllimshme. Izraeli ka kthyer urinë dhe frikën në mjete të qëllimshme: një “armatim i vërtetë” i vuajtjes, për të thyer qëndrueshmërinë e popullsisë dhe për të detyruar

një eksod nga Gaza. Mesazhi është i qartë: asnjë ent palestinez nuk do të kontrollojë Gazën pa miratimin e Izraelit. Lufta është kthyer në një instrument të inxhinierisë gjeopolitike. Vuajtja civile, e shkaktuar në mënyrë metodike, nuk është një efekt anësor, por një zgjedhje e qëllimshme. Ky skenar konfirmon kolapsin e çdo përpjekjeje etike për ta ndalur: Kufizimet që, në të kaluarën, ndalonin përdorimin e forcës nga demokracitë, po zhduken. Sot mbrojtja e civilëve është e negociueshme. Lufta është menaxhim. Etika është llogari. Pasojat janë potencialisht shkatërruese. Gaza mund të shndërrohet në një inkubator të një radikalizimi të ri xhihadist. Një brez i raskapitur do të gjejë në dhunë dhe në vdekje të vetmen gjuhë të mundshme. Përndimi rrezikon një delegjitimim të thellë, duke u shfaqur i painterësuar, bashkëfajtor dhe selektiv.

Presioni mbi Jordaninë, Egjiptin dhe Libanin, të paaftë për të pranuar refugjatë të rinj, rrezikon ta kthejë krizën në një gjendje të përhershme. Numri i papërballueshëm i viktimave civile në Gaza nuk është thjesht një tragjedi humanitare: është prova që dhuna sistemike ka zëvendësuar rregullin. Vuajtja është kthyer në një instrument strukturor. Terrori është një operacion strategjik. Në Gaza kemi hyrë në epokën e “paqes së zhveshur”: paqe e shkatërruar, jo më rregull, jo më përjashtim. Konfliktet zgjidhen me mjete ushtarake, ekonomike, teknologjike, pa kufij dhe pa të drejta. Në këtë fazë, Gaza është epiqendra, Netanyahu është pararendësi cinik, heshtja globale është sinjali më alarmues. Gaza zbulon krizën e rendit ndërkombëtar, të etikës dhe të besueshmërisë ndërkombëtare. / La Stampa – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Shehi: Duhet të jemi me këmbë në tokë dhe të fokusohemi në ndeshjen e radhës

Trajneri i Ballkanit, Orges Shehi, ka folur pas fitores së ekipit të tij në rrethin e dytë të Ligës së Konferencës. Ndeshja u zhvillua në rrethin e parë kualifikues, me

Ballkanin që mori një fitore të madhe ndaj Florianas të Maltës (4-2). Pas ndeshjes, Shehi u shpreh i kënaqur me fitoren, por tha se duhet të qëndrojnë me këmbë në tokë.

“Rëndësi ka fitorja. Edhe pse nisëm keq, treguam karakter. Nuk e humbëm durimin dhe arritëm te fitorja. Pësuam dy gola shumë të lehtë. Kjo ndodh në futboll dhe nuk dua të

fajësojë lojtarët. Kemi mundur të luajmë edhe më mirë. Ballkani ka kaluar tranzicion të madh. Duhet të jemi me këmbë në tokë dhe të fokusohemi vetëm në

ndeshjen e radhës. Morëm një rezultat pozitiv, por ndeshja e dytë do të jetë edhe më e vështirë”, ka thënë Shehi. Ndeshja e kthimit luhet javën e ardhshme në Maltë.

KB BASHKIMI DHE KBF PEJA MËSOJNË KUNDËRSHTARËT NË GARAT EVROPIANE

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Dy klubet kosovare të basketbollit, Bashkimi në konkurrencën e meshkujve dhe Peja në konkurrencën e femrave i kanë mësuar kundërshtarët për garat evropiane. KB Bashkimi debuton në sezonin 2025/26 në garat e evropiane. Skuadra nënkampione e Kosovës në basketboll nuk ka pasur fat në shortin e kualifikimeve për FIBA Europe Cup. Skuadra nga Prizreni do të përballlet me ekipin e madh nga Polonia, Anwil për një vend në Grupin F të stinorit të rregullt. Anwil është një emër me traditë në basketbollin evropian, me pjesëmarrje të rregullta në garat ndërkombëtare dhe një përvojë të pasur në skenën e madhe. Nga ana tjetër, BC Bashkimi, klubi më i vjetër i basketbollit në Kosovë po e kërkon lavdinë ndërkombëtare, dhe këtë sezon hyn me ambicie për të treguar fuqinë e basketbollit prizrenas në arenën evropiane. “Pas hedhjes së shortit për kualifikimet e FIBA Europe Cup, ekipi ynë do të përballlet me skuadrën polake Anwil Wloclawek – një ndër klubet më të suksesshme në basketbollin polak dhe me përvojë të madhe në garat evropiane”, thuhet në njoftimin e Bashkimit. Bashkimi e Anwili do ti luajnë dy ndeshje, vajtje - ardhje dhe fituesi do të jetë pjesë e FIBA Europe Cup kurse humbësi do të eliminohet.



Duelet e para të kualifikimeve të FIBA Europe Cup, do të luhen më 24 shtator kurse ato të kthimit më datën 1 tetor. Klubi nga Prizreni ka bërë me dije se ka synime të mëdha në këtë përballje: “Synimi ynë do të jetë i qartë: të japim maksimumin për të kaluar në fazën tjetër dhe për të përfaqësuar me krenari klubin tonë në Evropë”. Në nën tjetër, KBF Peja mëson kundërshtarët për debutimin historik në FIBA EuroCup Women. Nënkampionia e Kosovës në basketbollin e femrave debuton në edicionin 2025/26. Ky është një moment historik jo vetëm për klubin nga Peja, por edhe për basketbollin e femrave në Kosovë, duke shënuar një tjetër hap të madh drejt afirmimit në

arenën ndërkombëtare. Skuadra pejane do të jetë pjesë e Grupit F, ku tashmë janë konfirmuar tri kundërshtarë, ndërsa emri i skuadrës së katërt do të përcaktohet pas ndeshjeve kualifikuese që zhvillohen në fund të muajit shtator. “Klubi ynë KBF Peja 03 do të jetë pjesë e Grupit F, ku do të garojë përkrah skuadrës çeke Levhartice BK Levharti Chomutov, ekipit gjerman Rutronik Stars Keltern dhe humbësit nga përballja mes Tango Bourges dhe Kibirkstis Vilnius – ku fituesi kalon në Euroligë, ndërsa humbësi vjen në grupin tonë. Një moment i veçantë për klubin dhe për basketbollin e femrave në Kosovë”, thuhet në reagimin e klubit të Pejës.

SHKURT

UEFA delegon Visar Kastratin në Ligën e Konferencës

UEFA delegon sërish Visar Kastratin si gjyqtar kryesor në një ndeshje. Kësaj here, Kastrati i është besuar detyra për ta ndarë drejtësinë në ndeshjen Hibernians – Spartak Trnava në kuadër të raundit të dytë të garës Ligës së Konferencës. Ndeshja do të zhvillohet në stadiumin Tony Bezzina në Paola të Maltës, ku Kastratin do ta asistojnë Besnik Morina dhe Granit Hyseni. Gjyqtar i katërt do të jetë Alban Shala. Kjo ndeshje do të luhet të enjten, më 24 korrik, me fillim në orën 18:00.

Në Obiliq turneu i hendbollit në rërë

Prej të premtës e deri të dielën në Obiliq mbahet turneu atraktiv i hendbollit në rërë. “Summer Beach Tournament” organizohet nga Federata e Hendbollit e Kosovës në bashkëpunim me KHF Tereza. Turneu është kualifikues për ngjarjet ndërkombëtare në “Beach Handball”, ndërsa zhvillohet në të dy konkurrencat. Gara pritet të zhvillohet nga gjashtë ekipe të meshkujve dhe gjashtë të femrave. Ndeshjet zhvillohen prej orës 19:30 në sheshin “Adem Preniqi” në Obiliq. Në fushën e hendbollit të ngritur në këtë shesh, tashmë është organizuar një turne i hendbollit në rërë për grupmosha të reja.

Deondre Burns, përforcimi i parë i huaj te KB Prishtina

KB Sigal Prishtina ka bërë edhe përforcimin e parë të huaj për sezonin 2025/26. Sigal Prishtina të mërkurën e ka paraqitur amerikanin Deondre Burns i cili luan në pozitën e fundorit dhe është i gjatë 191 centimetra. 28-vjeçari prej vitit 2020 bën karrierë në Evropë, ndërsa ka luajtur në Zvicër, Qipro, Suedi, Izrael dhe Francë. Madje, në Qipro, me skuadrën Keravnos, Burns ka fituar titullin e kampionit, Kupën dhe Superkupën. Sezonin e fundit Burns ka qenë pjesë e ekipit nga Franca, Le Portel për një periudhë të shkurtër pasi i është bashkuar nga Hapoel Holoni. Në dy ndeshje të luajtura me Le Portelin në FIBA Europe Cup, Burns ka pasur një mesatare prej 10 pikëve, 2 kërcimeve dhe po aq asistimeve.

FIFA dënon Shqipërinë për incidentet në ndeshjen kundër Serbisë

TIRANË, 23 KORRIK - Federata Shqiptare e Futbollit është njoftuar zyrtarisht nga FIFA për një vendim disiplinor pas ndeshjes Shqipëri - Serbi, e zhvilluar më 7 qershor 2025 në stadiumin “Air Albania”. Sipas vendimit, FShF-ja dënohet me një gjobë prej 161 500 frangash zvicerane dhe detyrimin që ndeshja e radhës në shtëpi ndaj Letonisë të luhet me të paktën 20

% të kapacitetit të stadiumit të mbyllur për publikun për shkak të sjelljeve të përsëritura të papërshtatshme dhe diskriminuese të një pjese të tifozëve shqiptarë (këngë me përmbajtje diskriminuese, hedhje objektesh, ndezje fishekzjarrësh, përdorim i gjeleve apo mesazheve të papërshtatshme për një ngjarje sportive, si dhe ndërprerje gjatë himneve

kombëtare). Ky vendim është një penalizim serioz për gjithë komunitetin futbolistik dhe dëmtton jo vetëm Federatën, por Kombëtaren. FShF u bënë thirrje të gjithë tifozëve të Kombëtares që të shmangin çdo veprim që mund ta dëmtojë skuadrën, t'i respektojnë rregullat ndërkombëtare dhe të kontribuojnë për një atmosferë dinjitoze në mbështetje të Shqipërisë.



Milani pëson humbje në miqësoren ndaj Arsenalit

SINGAPOR, 23 KORRIK - Në miqësoren e parë verore, të zhvilluar në Singapor kundër Arsenalit, Milani është mposhtur me rezultatin minimal 1-0, një humbje e ngushtë, por e qartë në lojë dhe dominim. Golin e vetëm

të takimit e realizoi Bukayo Saka në minutën e 53-të, pas një pjese të parë ku londinezët e kontrolluan plotësisht lojën. Statistikat janë të pamëshirshme: 23 goditje në portë për Arsenalin kundrejt vetëm 2

për Milanin, që u detyrua të mbrohej për pjesën më të madhe të ndeshjes. Në pjesën e dytë Allegri u dha hapësirë të rinjve, mes të cilëve u dallua portieri Torriani, që realizoi katër pritje vendimtare radhazi

dhe mbajti rezultatin e ngushtë. Për Milanin, i vetmi rast i pastër ishte një mundësi e humbur nga Leao në pjesën e parë, një shans i artë që mund ta kishte ndryshuar rrjedhën e ndeshjes.



Trajneri i Leverkusenit: Xhaka nuk mund të ikë, është lideri ynë

LEVERKUSEN, 23 KORRIK - As Milani e as Interi, me Granit Xhakën që “driblon” dy ekipet e Serisë A pasi dëshira e tij është të rikthehet në Premierë Ligë, madje agjentit i tij ka zbuluar edhe destinacionin e tij të radhës. “Kemi gjetur një akord total me Sunderlendingin. Graniti dëshiron të rikthehet në Premierë Ligë. Sunderlendi ka entuziazëm dhe Xhaka e ka pranuar këtë sfidë. Shpresojmë që Leverkuseni ta respektojë dëshirën e lojtarit për t’u larguar, për të gjetur më pas një akord final edhe mes klubeve”, u shpreh agjenti i tij. Pavarësisht prej dëshirës së lojtarit dhe fjalëve të agjentit, Bayer Leverkuseni as që ka ndër mend ta lë të lirë Xhakën. I pari që reagoi mbi këtë çështje ishte trajneri Ten Hag: “Agjenti i tij mund të thotë çfarë të dojë, por Leverkuseni ka lënë tashmë të lirë tre lojtarë shumë të rëndësishëm si Florian Wirtz, Jeremie Frimpong e Jonathan



Tah. Ne nuk do të lejojmë që të largohet edhe ai. Graniti është një lider, ka ende tre vjet kontratë. Ai është një lojtar kyç për ne, shumë i rëndësishëm për ta lënë të ikë”. Të njëjtën mendim me trajnerin ka edhe drejtori sportiv i aspirinave, Simon Rolfes. “E kam përsëritur në më shumë se një

herë, Graniti është një lider, është shumë i rëndësishëm. Kam folur edhe me trajnerin. Kemi diskutuar me të gjitha palët. Graniti ka edhe tri vjet kontratë. Nëse do të largohet, mund të ndodhë vetëm nëse të tri palët do të bihen dakord”, u shpreh drejtori sportiv i Leverkusenit.

Norris: Dua titullin kampion në Formula 1

Bristol, 23 korrik - Pas vendit të dytë vjet në Botërorin e Formulës 1, piloti britanik Lando Norris synon ta rrëmbejë kurorën këtë sezon. Rivali kryesor për titull është shoku i tij i skuadrës te McLaren, australiani Oscar Piastri. Aktualisht Piastri ka një epërsi prej tetë pikësh në gjysmën e sezonit, por Norrisi, pas një periudhe zhgënjyese, vjen nga dy fitore radhazi që i kanë ringjallur ambiciet. Gjithsesi, ai është kritikuar shpesh për një mungesë të perceptuar të vendosmërisë konkurruese dhe qëndrueshmërisë nën presion. “Secili ka ëndrrat dhe aspiratat e veta. Dhe padyshim, e imja është të fitoj dhe të qëndroj në shkallën më të lartë. Unë fillova të garoj vetëm sepse më pëlqen të ngas makinën, jo sepse doja të fitoja një garë. Burimi im më i madh i motivimit është ekipi im”, ka thënë Norris, i cili foli edhe në



lidhje me presionin: “Momenti kur ndjeva presionin më të madh ishte Abu Dhabi sezonin e kaluar. Në atë moment ndjeva sikur kisha të gjithë ekipin në shpinë. Shumë njerëz varen nga unë për ta fituar kampionatin. Dhe e dija që duhej ta bëja këtë. Ishte një histori e shkëlqyer. Kështu që ishte kënaqësi të isha pjesë e saj”. “Ëndrra ime është të bëhem

kampion bote, por kjo është një gjë personale. Nuk është diçka për të cilën do të doja që njerëzit të më kujtonin pas 30 vjetësh. Mendoj se bota ecën shumë shpejt dhe fitimi i titullit ndoshta nuk do të thotë shumë pas 30 vjetësh. Do të doja të më kujtonin vetëm për faktin se isha një njeri i mirë, më shumë se për çdo gjë tjetër”, ka deklaruar Norrisi.

SHKURT

Augsburgu synon ta shesë Rexhbeçajn

Mesfushori i Kombëtares së Kosovës, Elvis Rexhbeçaj, pritet të largohet nga skuadra gjermane e Augsburgut gjatë kësaj vere. Sipas raportimeve të medieve në Gjermani, trajneri i ri i klubit, Sandro Wagner, nuk llogarit në shërbimet e 27-vjeçarit dhe këtë vendim ua ka komunikuar edhe drejtuesve të klubit gjatë fazës përgatitore. Në sezonin e kaluar të Bundesligës, Rexhbeçaj regjistroi vetëm një gol dhe një asistim në 27 paraqitje, ndërkohë që kontrata e tij me Augsburgun skadon verën e ardhshme. Duke marrë parasysh këtë situatë, drejtuesit e klubit kanë vendosur ta vendosin futbollistin në listën e lojtarëve të gatshëm për shitje dhe tashmë janë në pritje të ofertave për kartonin e tij i cili vlerësohet rreth 3 milionë euro. Përpara se të transferohej tek Augsburgu, Rexhbeçaj ka qenë pjesë e skuadrave të njohura gjermane si Wolfsburg, Bochumi dhe Kolni.

Luis Diaz pranon ofertën e Bayernit, Liverpooli arkëton 75 milionë euro

E ardhmja e Luis Diazit te Liverpooli është vënë në pikëpyetje, pasi mesfushori ofensiv kolumbian nuk bën më pjesë në planet e trajnerit Arne Slot. Pas një merkatoje të zjarrtë nga “The Reds”, interesimi nga Bayern Munichu është konkretizuar me një ofertë prej 75 milionë eurosh. Gjiganti gjerman e sheh 27-vjeçarin si përf forcimin ideal për repartin ofensiv, ndërsa edhe vetë lojtari nuk është kundër një transferimi në Bundesliga dhe një klub siç është Bayern Muncheni.

Çalhanoglu: Nuk largohem, dua të fitoj trofe me Interin

Mesfushori turk i Interit dhe kapiteni i Kombëtares së Turqisë, Hakan Çalhanoglu, ka hedhur poshtë zërat për një rikthim në Turqi, mes spekulimeve që e lidhin me Galatasarayn dhe Fenerbahçen. “Pushimet nuk ishin të lehta për shkak të spekulimeve, por jam i lumtur që jam kthyer dhe dua të punoj fort për Interin. Unë jam një lojtar i Interit dhe gjithmonë kam thënë se dua të vazhdoj këtu. Qëllimi im është të fitoj trofe”, ka thënë Çalhanoglu.

Gyokeres transferohet tek Arsenal

Sulmuesi Victor Gyokeres është tashmë zyrtarisht futbollist i Arsenalit. “Topçinjtë” mbyllën një nga goditjet më të mëdha të merkatos së verës, duke paguar 70 milionë euro për sulmuesin suedez, i cili shkëlqeu me Sporting Lisbonën me 97 gola në 102 ndeshje. Arsenali do të derdhë 63.5 milionë euro menjëherë, ndërsa pjesa tjetër do të vijë në formë bonusesh. Vendimtare në marrëveshje ishte dëshira e lojtarit për t’u bashkuar me skuadrën e Artetës, duke refuzuar ofertat e tjera, përfshirë edhe atë të Manchester Unitedit. Me Gyokeres në majë të sulmit, Arsenali synon seriozisht titullin në Premierë Ligë.

Komiteti Olimpik Amerikan zbaton urdhrin e Trumpit: Asnjë atlet transgjitor në garat e femrave

Asnjë atlet transgjitor nuk lejohet në garat e femrave në Shtetet e Bashkuara. Komiteti Olimpik dhe Paralimpik i ShBA-së e ka

konfirmuar këtë, duke njoftuar Federatën e Notit, të Atletikës dhe të sporteve të tjera se ato kanë një “detyrim për t’u pajtuar” me urdhrin

ekzekutiv të presidentit Donald Trump. Politika e re, e njoftuar të hënën me një përditësim në faqen e internetit të USOPC dhe e

konfirmuar në një letër drejtuar organeve kombëtare drejtuese të sportit, vjen pas një mase të ngjashme të miratuar nga NCAA në fillim

të këtij viti, e cila preku, ndër të tjera, notaren Lia Thomas, atleten e parë transjinore që fitoi një kampionat të Divizionit të NCAA-s.



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Shërbimi

Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (1 dhjetor 2024)

I BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: "Shërbime të testimit dhe vlerësimit të sigurisë së sistemeve IT (dy pjesë/lote)

II.2 Numërtimi i Prokurimit: "BQK 25 052 221"

III VENDI I REALIZIMIT TË SHËRBIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Garibaldi" nr. 33, 10000 Prishtinë

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderit

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata të tjera administrative:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 01.08.2025 ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 01.08.2025 ora 14:00.

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve, data: 05.08.2025, ora 14:00;

Adresa: objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë:

V.3 Takimi për hapjen e tenderëve, data: 05.08.2025, ora 14:30; vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

V.4 Kushti i sigurimit të tenderit:

Per pjesën/lot 1 (nje): 2,000.00 € (dy/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë).

Per pjesën/lot 2 (dy): 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë).

V.5 Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë është në dispozicion në ueb-faqen e BQK-së: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)", respektivisht sipas Neni 48 "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Victory BA SA" SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811407156 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Victory BA SA" D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811407156 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Victory BA SA" L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811407156 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Rent A Car ARX" SH.P.K. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812090728 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Rent A Car ARX" D.O.O. Glllogoc donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812090728 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Rent A Car ARX" L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 812090728 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

